

Vendim nr. 248 datë 03.10.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 03.10.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (B) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BLENDO (EDISON) ALIKAJ**, përfaqësuar nga av. Arsen Çaushaj, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 234, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 319, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Apelit të Vlorë; nr. 00-2025-346 (58), datë 27.02.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 5, 15, 27, 29, 30, 31, 32, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 1, 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe protokolli nr. 12 i saj; nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është akuzuar për kryerjen e veprave penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, të mbetur në tentativë dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22, si dhe 278 të Kodit Penal (KP).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 234, datë 14.05.2018, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese”, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 22 të KP-së dhe dënimin e tij me 24 (njëzet e katër) vjet burgim. Deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë, i KP-së dhe dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, dënimin e kërkuesit me një dënim të vetëm prej 24 (njëzet e katër) vjetësh burgim”. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 319, datë 18.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 234, datë 14.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2025-346 (58), datë 27.02.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 319, datë 18.07.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Në datën 18.07.2025, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të nenit 27, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 30.07.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

6.1. *Lirisë personale dhe parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, pasi gjykatat në rastin e tij kanë gabuar dhe kanë shkelur ligjin, për shkak se ai është dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme, siç është njohja, që është një akt i pavlefshëm, se është kryer në kundërshtim me nenet 79/1, 128/1 shkronjat “b” dhe “c”, 128/2, 151/4, 304/2, 313, 171 dhe 172 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ligjin “Për funksionimin e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë e Shtetit” dhe nenet 27 e 28 të

Kushtetutës. Po ashtu, gjykatat kanë gabuar dhe kanë shkelur ligjin për mënyrën sesi janë marrë provat me të cilat është deklaruar fajtor kërkuesi. Gjykatat duhet të deklaronin relativisht të pavlefshëm procesverbalin e paraqitjes për njohje të datës 05.01.2017, ora 02:10, të shtetasve F.K., M.Sh. dhe I.Sh., si dhe tabelën fotografike të datës 05.01.2017. Ndjekja penale dhe kryerja e veprimeve hetimore janë kryer përtej afatit të hetimeve, në kundërshtim me nenin 323 të KPP-së dhe për këtë arsye të gjitha aktet e nxjerra përtej këtij afati konsiderohen të pavlefshme.

- 6.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Ai Kolegj nuk ka vlerësuar pretendimet e kërkuesit se gjykatat kanë vendosur mbi bazën e provave të marra në kundërshtim me ligjin. Në rekurs ishte ngritur pretendimi për dallimin midis pavlefshmërisë dhe papërdorshmërisë së akteve, si dy koncepte të ndryshme të parashikuara nga nenet 128 dhe 129 të KPP-së dhe Kolegji Penal nuk mbajti një qëndrim për këtë pretendim. Edhe gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkuesi. Gjykatat kanë gabuar, pasi kërkuesi nuk mund të ndodhej njëkohësisht edhe në katin e dytë të lokalit “Bis Park”, edhe në vendin e ngjarjes.
- 6.3. *Sigurisë juridike*, pasi nga analiza tërësore e akteve që kanë vlerën e provës, nuk rezulton asnjë provë direkte ose indirekte për të arritur në përfundimin e deklarimit fajtor të kërkuesit.
- 6.4. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat kanë rrëzuar pa shkaqe të arsyeshme kërkesat e mbrojtësit të kërkuesit për ekspertimin mjeko-ligjor dhe nuk janë shprehur për kërkesën e tij për pavlefshmëri. Po ashtu, ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosshpjegimit dhe mosanalizimit nga ana e saj të këtyre shkeljeve ligjore të gjykatave më të ulëta, të cilat sjellin pavlefshmërinë e vendimeve gjyqësore. Këto shkelje reflektojnë një opinion të gjykatave se kërkuesi është fajtor përpara se të provohej fajësia e tij.
- 6.5. *Parimit të paanshmërisë, si rrjedhojë e cenimit të parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykatat kanë paragjykuar duke i dhënë vlerë të paracaktuar provës së pavlefshme e të papërdorshme, njohjes me anë të sugjerimit, hamendjes e imagjinatës së oficerit të Policisë Gjyqësore, të formuar në shkelje të dispozitave kushtetuese e ligjore. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh dëshminë e shtetasit C.D., e cila ka deklaruar se ditën e ngjarjes kërkuesi ka qenë në shtëpinë e saj nga ora 21:00 deri në orën 23:30. Paraqitja për njohje nga oficeri i Policisë Gjyqësore dhe

veprimet e tjera hetimore janë kryer në kundërshtim me ligjin. Kolegji Penal nuk i ka marrë parasysh provat e krijuara në seancë gjyqësore.

- 6.6. *Së drejtës për mbrojtje efektive*, pasi gjatë fazës së hetimeve paraprake kërkuesi nuk është njoftuar rregullisht, si dhe mbrojtësve të tij nuk u është dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen. Po ashtu, mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata nuk ka qenë i përshtatshëm për të realizuar mbrojtjen, për shkak se nuk ka paraqitur asnjë kërkesë procedurale në interes të kërkuesit dhe ai i është nënshtruar veprimit procedural të “njohjes” pa praninë e mbrojtësit të tij dhe pa iu bërë e ditur e drejta e mbrojtjes. Njohja është zhvilluar pa u formalizuar proceduralisht arrestimi ose ndalimi i kërkuesit, si dhe pa iu komunikuar akuza ose shkak i ndalimit.
- 6.7. *Së drejtës për të mos u dënuar pa ligj lidhur me parimin e proporcionalitetit në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi interpretimi i ligjit i bërë nga Gjykata e Lartë është arbitrar. Arsyetimi i bërë nga Kolegji Penal, por edhe ai i gjykatave më të ulëta është i pamjaftueshëm, i paqartë, si dhe ka kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Gjykatat nuk kanë arsyetuar përse i kanë quajtur të papranueshme deklaratimet e tetë dëshmitarëve, si dhe aktet provuese të cilat vërtetojnë se kërkuesi nuk e ka kryer veprën penale.
- 6.8. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat nuk e kanë lejuar kërkuesin të pohojë dhe të prapësojë mbi çdo fakt ose element provues të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjykatat kanë vendosur pa dëgjuar arsyet e palëve. Asnjë nga viktimat e veprës penale nuk e ka identifikuar kërkuesin si autor të veprës penale, madje kanë këmbëngulur se nuk është ai autori. Kërkuesi është vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës, të cilit i është dhënë mundësia të paraqesë pretendimet dhe provat pa iu nënshtruar një verifikimi thelbësor në lidhje me mënyrën e marrjes së tyre.
- 6.9. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në fashikullin e gjykimin nuk ndodhet shtesa e rekursit prej 152 faqesh, për të cilën nuk është shprehur dhe as ka arsyetuar Kolegji Penal. Nëse Kolegji Penal do të shqyrtonte këtë shtesë rekursi, vendimmarrja do të ishte ndryshe dhe rekursi do të pranohej. Relacioni për shqyrtim paraprak në Kolegjin Penal nuk është nënshkruar nga relatori i çështjes, gjyqtari M.B. Vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara dhe i japin vlerë të paracaktuar veprimeve hetimore të kryera nga oficerët e Policisë Gjyqësore. Arsyetimi i gjykatave është haptazi i paligjshëm, pasi provat e pafajësisë janë interpretuar si prova fajësie. Gjykatat kanë bërë një interpretim të njëanshëm të

provave. Argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe urdhëruese të vendimit dhe pjesët e vendimeve nuk formojnë një përmbajtje koherente. Mosparaqitja e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi krijon dyshime edhe për cenimin e së drejtës së ankimit dhe së drejtës për t’u dëgjuar.

6.10. *Së drejtës për t’u njoftuar*, pasi sipas aktit të përfaqësimit të depozituar me shtesën e rekursit, Kolegjit Penal i lindin detyrime të reja për njoftimin e kërkuesit për ditën dhe orën e gjyqimit. Pra, kërkuesi nuk është njoftuar rregullisht për gjykimin e çështjes së tij.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

9. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, Kolegji konstaton se ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

10. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj

nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastin kur kundërshtohet një vendim i Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për sa më lart, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 27.02.2025 i cili i është komunikuar njërit prej mbrojtësve të tij në datën 14.05.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.07.2025, pra brenda afatit 4-mujor.

12. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar se është cenuar *parimi i sigurisë juridike*, duke argumentuar se nga analiza tërësore e akteve që kanë vlerën e provës, nuk rezulton asnjë provë direkte ose indirekte për të arritur në përfundimin e deklarimit fajtor të tij, si dhe *parimi i prezumimit të pafajësisë*, për shkak se gjykatat kanë rrëzuar pa shkaqe të arsyeshme kërkesat e mbrojtësit të tij për ekspertimin mjeko-ligjor dhe nuk janë shprehur për kërkesën e tij për pavlefshmëri. Po sipas kërkuesit, parimi i prezumimit të pafajësisë është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosshpjegimit dhe mosanalizimit nga ana e saj të këtyre shkeljeve ligjore të gjykatave më të ulëta, të cilat sjellin pavlefshmërinë e vendimeve gjyqësore.

13. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të paanshmërisë, si rrjedhojë e cenimit të parimit të barazisë së armëve*, pasi gjykatat i kanë dhënë vlerë të paracaktuar provës së pavlefshme e të papërdorshme, njohjes me anë të sugjerimit, hamendjes e imagjinatës së oficerit të Policisë Gjyqësore, të formuar në shkelje të dispozitave kushtetuese e ligjore. Sipas tij, gjykatat nuk kanë marrë parasysh dëshminë e shtetases C.D., e cila ka deklaruar se ditën e ngjarjes kërkuesi ka qenë në shtëpinë e saj nga ora 21:00 deri në orën 23:30. Po sipas kërkuesit, paraqitja për njohje nga oficeri i Policisë Gjyqësore dhe veprimet e tjera hetimore janë kryer në kundërshtim me ligjin dhe Kolegji Penal nuk i ka marrë parasysh provat e krijuara në seancë gjyqësore.

14. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar vazhdimisht se vlerësimi provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij, përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të

zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, si dhe të vlerësimit të provave dhe fakteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, lidhur me argumentet e sjella nga kërkuesi në mbështetje të pretendimeve për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* dhe *parimit të paanshmërisë, si rrjedhojë e cenimit të parimit të barazisë së armëve*, Kolegji vëren se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështjen e vlerësimit të provave, të cilat nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa për sa u përket argumenteve të kërkuesit në mbështetje të pretendimit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, referuar thelbit të tyre, Kolegji konstaton se ai nuk ka sjellë asnjë argument kushtetues në mbështetje të këtij pretendimi dhe nuk ka arritur të provojë sesi vendimet/qëndrimet e gjykatave, vendimet e të cilave kundërshton, kanë cenuar parimin e prezumimit të pafajësisë. Për këto arsye, këto pretendime të kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, pavarësisht mënyrës sesi i ka ngritur ai, referuar thelbit të argumenteve të sjella në mbështetje të tyre, Kolegji vëren se ato lidhen me *parimin e mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, *parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të drejtën e mbrojtjes, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit*, si dhe *të drejtën për t'u njoftuar*. Këto pretendime *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë gabuar dhe kanë shkelur ligjin, për shkak se ai është dënuar vetëm mbi bazën e një prove të vetme, siç është njohja, e cila është një akt i pavlefshëm, për shkak se është kryer në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ato të KPP-së.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 57, datë 21.12.2012; nr. 47, datë 07.11.2011; nr. 23, datë 23.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt ligjor është i sanksionuar në nenin 32, pika 2, të Kushtetutës, sipas të cilit

askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme (*shih vendimet nr. 49, datë 29.09.2014; nr. 82, datë 21.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa më lart, në rastin konkret, Kolegji në vijim do të analizojë veprimin hetimor të quajtur “njohje” dhe si ka ndikuar ai në vlerësimin e gjykatave për shpalljen fajtor të kërkuesit për veprat penale për të cilat është akuzuar. Po ashtu, Kolegji do të analizojë edhe nëse kërkuesi është dënuar vetëm mbi bazën e këtij veprimi hetimor apo edhe mbi bazën e provave të tjera.

20. Në çështjen konkrete, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se në datën 04.01.2017, rreth orës 22:00, në lagjen “Hajro Cakëri” të qytetit të Vlorës është qëlluar me armë zjarri drejt një lokali, ku kanë mbetur të dëmtuar tre shtetas, të cilët më pas kanë bërë kallëzim penal për këtë ngjarje, duke përshkruar edhe personin, që sipas tyre ishte autori i veprës penale. Për këtë qëllim janë mbajtur edhe procesverbalet për kallëzimin e veprave penale nga personat e dëmtuar. Më qëllim identifikimin dhe zbulimin e autorit të faktit penal, në datën 05.01.2017 nga organi i akuzës është proceduar me veprimet hetimore të njohjes me anë të sistemit TIMS, pyetjes së dëshmitarëve të pranishëm në vendngjarje, këqyrjes së vendit të ngjarjes, marrjes dhe sekuestrimit të provave materiale, kontrollit të banesave etj. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, organi i akuzës ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të kërkuesit, duke e akuzuar atë për veprat penale për të cilat është dënuar, si dhe ka kryer veprimet e mëposhme procedurale për marrjen e tij si të pandehur dhe komunikimin e akuzave.

21. Po ashtu, përveç veprimit hetimor të titulluar “njohje”, në dosjen gjyqësore rezultojnë të administruara edhe disa akte të tjera, të tilla si procesverbalet për kallëzimin e veprës penale nga personat e dëmtuar, procesverbalet për marrjen e të dhënave nga personat që kanë dijeni për veprën penale, procesverbalet për sekuestrimin e provave materiale, aktet e ekspertimit balistik, akti i ekspertimit mjeko-ligjor etj., të cilat janë vlerësuar si prova nga gjykatat në raport me njëra-tjetrën. Ndërsa referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi, Kolegji konstaton se nga gjykata e shkallës së parë është marrë në shqyrtim pretendimi i tij për pavlefshmërinë e aktit hetimor të quajtur “njohje”. Sipas gjykatës së shkallës së parë “[...] njohja e kryer nga Policia Gjyqësore nuk është njohje në kuptim të neneve 172-175 të KPP-së, por një veprim procedural me qëllim identifikimin e të dyshuarit për vijimin e veprimeve të tjera hetimore” (*shih faqen 11 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*). Ky pretendim i kërkuesit është vlerësuar njësoj edhe nga gjykata e apelit, e cila ka arsyetuar se veprimi hetimor i quajtur “njohje” nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por indicie, e cila vlerësohet në raport me të gjitha provat e tjera (*shih faqen 8 të vendimit të*

Gjykatës së Apelit Vlorë). Këto përfundime të dy gjykatave më të ulëta janë vlerësuar të drejta nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, edhe sipas të cilit veprimi hetimor i titulluar “njohje” nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por ka pasur si qëllim vetëm identifikimin e personit të dyshuar si autor të mundshëm të veprës penale, në mënyrë që të vijohej me veprimet e tjera hetimore. Sipas Kolegjit Penal, nuk jemi përpara procedurës së njohjes me fotografi, pasi të dëmtuarit nga vepra penale e kanë njohur edhe më parë të gjykuarin (*shih paragrafët 19-20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Për sa më lart, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji evidenton se gjykatat në deklarinin fajtor të tij për faktet penale për të cilat është akuzuar, nuk janë bazuar në veprimin hetimor të titulluar “njohje”, por në provat e tjera të administruara dhe shqyrtuara në seancë gjyqësore në raport me njëra-tjetrën. Në rastin konkret, ashtu siç edhe kanë vlerësuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, Kolegji konstaton se akti hetimor i titulluar “njohje”, nuk është vlerësuar dhe as marrë si provë prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, por ka shërbyer vetëm për identifikimin e personit të dyshuar si autor i mundshëm i veprës penale, për të vijuar më tej me veprimet e tjera hetimore, për zbardhjen e plotë të ngjarjes dhe kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat për këtë pretendim. Për rrjedhojë, Kolegji evidenton se procesi i kundërshtuar nga kërkuesi, në drejtim të mënyrës së marrjes së provave, ka qenë i drejtë dhe në përputhje me nenin 32, pika 2, të Kushtetutës. Për këto arsye, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë ta paligjshme është haptazi i pabazuar.

23. Ndërkohë, Kolegji vëren se pjesa tjetër e argumenteve të kërkuesit të paraqitura me ankimin kushtetues individual në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë ta paligjshme, në thelb, ka të bëjë me çështje të vlerësimit dhe interpretimit të provave, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe së drejtës së mbrojtjes

24. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat nuk e kanë lejuar atë të pohojë dhe të prapësojë për çdo fakt ose element provues të rëndësishëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe se ato kanë vendosur pa dëgjuar arsyet e palëve. Sipas kërkuesit, ai është vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës. Po sipas kërkuesit, mbrojtësve të tij nuk u është dhënë kohë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen dhe mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata nuk ka qenë i përshtatshëm për të realizuar mbrojtjen, për shkak se nuk ka paraqitur asnjë kërkesë

procedurale në interes të kërkuesit. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se i është nënshtruar veprimit procedural të “njohjes” pa praninë e mbrojtësit të tij dhe pa iu bërë e ditur e drejta e mbrojtjes dhe se njohja është zhvilluar pa u formalizuar proceduralisht arrestimi ose ndalimi i tij, si dhe pa iu komunikuar akuza ose shkaku i ndalimit.

25. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t’i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njërës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa më lart, në vijim do të analizohet nga Kolegji nëse kërkuesit i është dhënë mundësia që të parashtrojë pretendime dhe të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij dhe provat mbi të cilat janë ngritur këto akuza. Po ashtu, Kolegji do të analizojë edhe nëse kërkuesit i është dhënë mundësia të paraqesë prova, të debatojë në lidhje me to e të marrë në pyetje dëshmitarët, në kushte të barabarta me organin e akuzës, si dhe nëse atij i është garantuar e drejta për mbrojtje efektive.

28. Në rastin konkret, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, Kolegji vëren se pas regjistrimit të procedimit penal, mbi kërkesën e organit të

akuzës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 08, datë 07.01.2027, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin dhe ka ngarkuar Policinë Gjyqësore për zbatimin e këtij vendimi. Pas kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi nga Policia Gjyqësore, është bërë e pamundur gjetja e kërkuesit. Për këtë arsye, organi i akuzës i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me kërkesën “Deklarimi i ikjes së kërkuesit” dhe “Caktimi i një mbrojtësi kryesisht” për mbrojtjen e të drejtave të tij. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me vendimin nr. 456, datë 10.05.2017, duke i caktuar kërkuesit si mbrojtës kryesisht avokatin A.Z.

29. Ndërkohë, për sa i përket gjykimit të themelit të çështjes së kërkuesit, Kolegji konstaton se gjykimi në gjykatën e shkallës së parë, pas heqjes dorë nga përfaqësimi i mbrojtësit të zgjedhur kryesisht, është zhvilluar në prani të mbrojtësit të zgjedhur nga kërkuesi sipas vullnetit të tij të shfaqur me prokurorë. Po kështu, përgjatë këtij gjykimi kërkuesi, ndër të tjera, ka parashtruar pretendimet e tij për sa i përket mosqenies autor i veprës penale, si dhe konstatimit si absolutisht të pavlefshme të akteve procedurale. Gjatë këtij gjykimi kërkuesi ka paraqitur dhe gjykata ka lejuar marrjen e provave, përfshirë edhe provat me dëshmitarë, ku këta të fundit janë pyetur lirisht nga mbrojtësi i kërkuesit. Po kështu, mbrojtësit të kërkuesit i është dhënë mundësia t’u bëjë pyetje dëshmitarëve, si dhe ka paraqitur prova e argumente në mbështetje të pretendimeve të tij.

30. Edhe në gjykatën e apelit kërkuesi është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij dhe shqyrtimi i çështjes i është nënshtruar debatit gjyqësor, ku mbrojtësi i kërkuesit ka pasur mundësinë të shprehet si për faktet e rrethanat e çështjes, ashtu edhe për gjetjet e gjykatës së shkallës së parë për pretendimet e tij për konstatimin si absolutisht të pavlefshme të akteve procedurale dhe pafajësinë e tij. Ai ka ushtruar lirisht rekurs ndaj vendimeve të gjykatave të faktit dhe në përgjigje të pretendimeve të tij Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka interpretuar drejt ligjin material penal në lidhje me elementet e veprave penale, të parashikuara nga nenet 79/dh-22 dhe 278/1 të KP-së, në raport me veprimet dhe mosveprimet e kërkuesit në kryerjen e veprave penale për të cilat është deklaruar fajtor. Po kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se veprimi hetimor është emërtuar “njohje”, por në vetvete nuk është njohje në kuptim të provës në procesin penal, e cila do të impononte respektimin e neneve 171-175 të KPP-së, dhe ai nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por indicie e cila vlerësohet në raport me të gjitha provat e tjera në gjykimin e kësaj çështjeje.

31. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji vëren se përgjatë procesit gjyqësor për deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale për të cilat është akuzuar, atij i është dhënë mundësia që, në kushte të barabarta me organin e ndjekjes penale, të parashtojë pretendimet dhe të kundërshtojë akuzat e ngritura ndaj tij dhe provat mbi të cilat janë ngritur

këto akuza, të paraqesë prova, të debatojë në lidhje me to e të marrë në pyetje dëshmitarët. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se nuk rezulton që kërkuesi të jetë vënë në pozita të pabarabarta me organin e akuzës. Po ashtu, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji vëren se gjatë gjykimit në gjykatat e faktit atij i është garantuar edhe e drejta e mbrojtjes. Kërkuesi ka zgjedhur me vullnetin e tij mbrojtësin për ta përfaqësuar në gjykim, i cili gjatë realizimit të mbrojtjes, ndër të tjera, ka paraqitur kërkesa procedurale dhe ka pasur kohë të mjaftueshme për realizimin e mbrojtjes. Në këtë kuptim, Kolegji evidenton se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i jepnin mundësinë kërkuesit të bënte mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

32. Në lidhje me pretendimin për papërshtatshmërinë e mbrojtësit të caktuar kryesisht, Kolegji konstaton se kërkuesi nuk ka sjellë ndonjë provë për të mbështetur këtë pretendim dhe nuk ka argumentuar sesi qëndrimet e tij kanë ndikuar në realizimin e mbrojtjes. Për më tepër, siç edhe është evidentuar më sipër, të drejtat e kërkuesit gjatë gjykimit janë mbrojtur nga mbrojtësit e zgjedhur nga vetë ai. Ndërsa për sa i takon veprimin procedural të titulluar “njohje”, Kolegji vëren se atij i janë nënshtruar personat e dëmtuar nga vepra penale dhe jo kërkuesi. Po ashtu, Kolegji konstaton se ky veprim procedural është kryer nga organi i akuzës direkt pas ngjarjes dhe pa qenë ende kërkuesi personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale. Në momentin që procedimi penal është regjistruar ndaj kërkuesit, nga organi i akuzës janë marrë të gjitha masat për gjetjen e tij dhe komunikimin e akuzave dhe shkakut të ndalimit, me qëllim realizimin e së drejtës së mbrojtjes. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parmit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës së mbrojtjes janë haptazi ta pabazuara.

33. Për sa i përket pjesës tjetër të argumenteve të kërkuesit të paraqitura në ankimin kushtetues individual në mbështetje të pretendimit për cenimin e parmit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe së drejtës së mbrojtjes, Kolegji vëren se në thelb ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe interpretimit të provave, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

Ç. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

34. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs. Sipas kërkuesit, arsyetimi i bërë nga Kolegji Penal, por edhe ai i gjykatave më të ulëta, është i pamjaftueshëm, i paqartë, si dhe ka kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose

të fshehtë. Po ashtu, kërkuesi ka argumentuar se argumentet e pjesës hyrëse të vendimeve nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe urdhëruese dhe ato nuk formojnë një përmbajtje koherente.

35. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se ai është element thelbësor i një vendimi të drejtë dhe se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 24, datë 09.04.2024; nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Lidhur me vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë, jurisprudenca kushtetuese ka vlerësuar se arsyetimi i kufizuar i tyre nuk cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomën e këshillimit është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42, pika 1, të Kushtetutës, e drejta e aksesit i garanton individit të drejtën t'i drejtohet një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tij dhe do të shpallë një vendim që u jep përgjigje atyre (pretendimeve). Ajo nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 73, datë 17.10.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Referuar standardeve të mësipërme kushtetuese, në vijim do të analizohet nga Kolegji nëse arsyetimi i gjykatave është mjaftueshëm i qartë në përmbajtje, nëse argumentet e pjesës arsyetuese janë të lidhura logjikisht dhe formojnë një përmbajtje koherente brenda

vendimit, duke përjashtuar çdo kundërthënie ose kontradiktë të hapur dhe nëse ato janë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese, si dhe nëse Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka marrë në shqyrtim dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit.

39. Në rastin konkret, referuar vendimit të gjykatës së shkallës së parë, objekt i këtij gjykimi kushtetues, rezulton se ajo gjykatë fillimisht ka shqyrtuar juridiksionin e saj dhe kompetencën lëndore. Më pas, gjykata e shkallës së parë ka bërë një përshkrim të fakteve dhe provave, duke i renditur dhe përshkruar ato, për të vijuar më tej në pjesën tjetër të vendimit që lidhet me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret. Në pjesën vijuese të vendimit, gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin e saj lidhur me elementet e veprave penale. Po ashtu, rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimin e kërkuarit për pavlefshmërinë e veprimeve hetimore që lidhen me aktin e titulluar “njohje”. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka shpallur dispozitivin e saj, duke e deklaruar fajtor kërkuarin për kryerjen e veprave penale për të cilat ai është akuzuar.

40. Mbi ankimin e kërkuarit, gjykata e apelit në vendimin e saj, pasi ka pasqyruar shkaqet e tij, ka vijuar me faktet e çështjes dhe më pas ka vlerësuar se vendimi i ankimit është i bazuar në prova dhe në ligj, dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi. Edhe gjykata e apelit në vendimin e saj ka arsyetuar në lidhje me elementet e veprave penale dhe me pretendimet e kërkuarit, përfshirë atë për pavlefshmërinë e veprimit hetimor të titulluar “njohje”. Në përfundim, në dispozitivin e vendimit të saj, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

41. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka interpretuar drejt ligjin material penal në lidhje me elementet e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh-22 dhe 278/1 të KP-së, në raport me veprimet dhe mosveprimet e kërkuarit në kryerjen e veprave penale për të cilat është deklaruar fajtor. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i gjykatës së apelit ka respektuar edhe standardin e arsyetimit të vendimeve, duke u dhënë përgjigje pretendimeve të të gjykuarit në përputhje me ligjin. Po ashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka arsyetuar në lidhje me pretendimin e kërkuarit për veprimin hetimor të titulluar “njohje”, për të cilin ka vlerësuar se ai është një veprim hetimor që ka pasur për qëllim identifikimin e personit të dyshuar si autor të mundshëm në mënyrë që të kryheshin veprimet e mëtejshme hetimore, pra nuk përbën provë në kuptim të nenit 149 të KPP-së, por indicie e cila vlerësohet në raport me të gjitha provat e tjera në gjykimin e kësaj çështjeje. Në përfundim, Kolegji Penal ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë në tërësi me vlerësimin e provave dhe nuk rezulton që gjykata e apelit të jetë në kushtet e nenit 432 të KPP-së.

42. Në rastin konkret, duke iu referuar arsyetimit të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij të ngritura në rekurs, duke e vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e gjykatës së apelit. Po kështu, Kolegji vëren se arsyetimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë plotëson kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij, duke qenë se arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nuk ka cenuar standardin kushtetues të arsyetimit, në kushtet kur ai kolegji në vendimin e tij ka parashtruar shkaqet e rekursit. Po ashtu, referuar vendimeve të mësipërme objekt të këtij gjykimi kushtetues, Kolegji konstaton se arsyetimi i tyre nuk është jokohërent ose që ai të ketë kundërthënie ose kontradiksion, ndërkohë që pjesët arsyetuese janë të mjaftueshme për të mbështetur ato që janë vendosur në pjesën urdhëruese. Ato vendime nuk rezultojnë të jenë alogjike dhe të mos kenë referencë në ligjin e zbatueshëm. Për këto arsye, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të lidhur me të drejtën e aksesit, është haptazi i pabazuar.

43. Për sa i përket pjesës tjetër të argumenteve të kërkuesit të paraqitura në ankimin kushtetues individual në mbështetje të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me të drejtën e aksesit, Kolegji vëren se në thelb ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe interpretimit të provave, të cilat nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, por në atë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

D. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së njoftimit

44. Kërkuesi ka pretenduar se sipas aktit të përfaqësimit të depozituar me shtesën e rekursit, Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë i lindnin detyrime të reja për njoftimin e tij për ditën dhe orën e gjykimit. Pra, sipas kërkuesit, ai nuk është njoftuar rregullisht për gjykimin e çështjes së tij.

45. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Për sa më lart, në vijim do të analizohet nga Kolegji procedura e njoftimit të kërkuarit për datën, orën e gjykit dhe përbërjen e trupit gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe si ka ndikuar kjo procedurë në zhvillimin e gjykit në këndvështrim të garantimit të së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për t'u dëgjuar.

47. Për shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, neni 436/a, pika 1, i KPP-së parashikon shqyrtimin e rekursit për kushtet e pranueshmërisë në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson kushtet e pranueshmërisë, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh ose në prani të palëve (*neni 437 i KPP-së*), shqyrtim për të cilin palët njoftohen për datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 30 ditë përpara datës së shqyrtimit, përmes shpalljes në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykit (*neni 436, pika 3, i KPP-së*).

48. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e kërkuarit. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, rubrika “Çështje të shpallura për gjykim”, për kategorinë “Çështje penale”, nën rubrika “Për shqyrtim në dhomë këshillimi”, rezulton se në datën 17.01.2025 është shpallur lista e çështjeve për shqyrtim në datën 27.02.2025, ora e seancës, si dhe përbërja e trupit gjykues për çdo çështje, listë në të cilën pasqyrohet edhe çështja e kërkuarit. Po ashtu, nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, rezulton se njoftimi për datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues është afishuar edhe në ambientet fizike të asaj gjykate. Në procesverbalin e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, që mban datën 27.02.2025, është shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit, me anë të shpalljes publike në datën 17.01.2025. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit. Po ashtu, referuar akteve ankimore të depozituara nga kërkuari në Gjykatën e Lartë (rekurs dhe plotësim rekursi), rezulton se përfaqësuesit e tij kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit. Ndërkohë që nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton që Gjykata e Lartë t'i ketë njoftuar ata elektronikisht për datën, orën dhe përbërjen e trupit gjykues.

49. Në lidhje me mangësinë procedurale të konstatuar në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, në drejtim të njoftimit të palëve, Gjykata ka vlerësuar se një mangësi e tillë duhet analizuar në aspektin e ndikimit të saj në të drejtën kushtetuese të aksesit substancial, të lidhur me të drejta të tjera procedurale kushtetuese për kërkuarin. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se jo çdo shkelje procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e respektimit të të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje

thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, Gjykata vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Duke iu referuar këtyre standardeve, Kolegji evidenton se mungesa e njoftimit nga Gjykata e Lartë e datës, orës së zhvillimit të gjykimit dhe përbërjes së trupit gjykues në adresat elektronike të mbrojtësve të kërkuesit, sipas përcaktimit të nenit 436, pika 3, të KPP-së, nuk rezulton ta ketë vendosur kërkuesin në pozita të pafavorshme lidhur me të drejtën e aksesit në aspektin substancial të lidhur me të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Në nxjerrjen e këtij përfundimi mbahet në konsideratë fakti se, nga njëra anë, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga rekursi i kërkuesit, ku ai ka parashtruar pretendimet e tij kundër vendimeve të gjykatave më të ulëta. Po kështu, njoftimi për datën dhe orën e shqyrtimit të procesit të tij ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj, si dhe në faqen elektronike. Nga ana tjetër, kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë argument sesi kjo mungesë njoftimi ka ndikuar në cenimin e së drejtës për proces të procesit të rregullt dhe as sesi ky njoftim mund të passillte një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të palëve në adresat elektronike, në kontekst të rastit konkret, nuk mund të klasifikohet si shkelje thelbësore që e bën të parregullt në kuptimin kushtetues procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Për këto arsye, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar është i pabazuar.

51. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.